

**AKTI I THEMELIMIT**  
**DHE**  
**STATUTI**  
**I**  
**I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA**  
**LEKLI SCIENCES**

**KAPITULLI - I**  
**EMRI, FORMA, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1**  
**Themelimi dhe Regjistrimi**

1.1. Sot me datë 19.06.2024 me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statuti, themelohet sipas legjislacionit shqiptar, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **LEKLI SCIENCES** (në vijim “**Shoqëria**”)

1.2. Ortaku i Shoqërisë (“**Ortaku**”) gëzon përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e Shoqërisë të përfaqësuar në kuotën e Shoqërisë.

1.3. Në të gjitha dokumentet, faturat, njoftimet dhe botimet të lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, emri i saj do të ndiqet ose do të shoqërohet nga :

- fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "shpk".
- numri i Identifikimit Personal Tatimor (NUIS) te saj.
- adresa e regjistruar;
- pasqyrimi i faktit që shoqëria është në procedura likuidimi, nëse aplikohet.
- kapitalin e regjistruar dhe të paguar të Shoqërisë.

## **Neni 2 Forma Ligjore**

2.1. Shoqëria është një person juridik shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (“*shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*”), në pajtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“ (“**Ligji për Shoqëritë**”).

## **Neni 3 Selia**

3.1. Në momentin e nënshkrimit të këtij Statuti, selia ligjore e Shoqërisë ndodhet në adresën:

• **Rruga "Aleksander Goga", Lagjja nr.7, Pallati 800, Shk.1, Kati.1, Ap.3, ZK 8511. Selia ka qellime vetem administrative dhe ruajtje dokumentacioni. Ne seli nuk kryhet asnje aktivitet tregtar i shoqërisë (shitje, blerje, perpunim, magazinim)**

3.2 Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar në çdo ambient dhe në çdo territor të ndodhur në Republikën e Shqipërisë.

3.3 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë dhe kjo nuk do të konsiderohet si ndryshim i Statutit. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 4 Kohëzgjatja**

4.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

## **KAPITULLI - II**

### **OBJEKTI**

## **Neni 5 Objekti i Aktivitetit të Shoqërisë**

5.1. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është kryerja e çdo aktiviteti tregtar të lejuar nga legjislacioni shqiptar, dhe veçanërisht, por pa u kufizuar:

- a. Prodhimi dhe/ose tregtimi me shumicë dhe/ose pakicë i produkteve farmaceutike, importi dhe/ose eksporti i produkteve farmaceutike, paketimi, shpërndarja e produkteve farmaceutike;
- b. Aktivitet kërkimor shkencor në fushën e produkteve farmaceutike;
- c. Aktivitete promovuese, aktivitete marketingu, konferenca;
- d. Zotërim dhe administrim patentash, të drejta autorit, markash tregtare;

- e. Zotërim titujsh, aksione, kuota apo pjesëmarrje të tjera në kapitale të shoqërive tregtare;
- f. Çdo aktivitet tjetër ndihmës dhe aksesor i cili realizohet për qëllimin e përmbushjes së aktiviteteve të mësipërme

### **Neni 6 Ndryshime**

6.1. Shoqëria ka të drejte të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.

## **KAPITULLI - III**

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT E KAPITALIT THEMELTAR**

#### **Neni 7 Kapitali Themeltar**

7.1 Kapitali i Shoqërisë është 1.000 Lekë (një mijë Lekë) i përfaqësuar tërësisht nga **1 (një) kuotë** (më tej "**Kuota**")

#### **Neni 8 Ortaku dhe Kuota**

8.1 Në datën e këtij Statuti, Shoqëria ka vetëm një Ortak i cili vepron në cilësinë e Ortakut të Vetëm dhe është nënshkruar dhe zotëruar i të gjithë Kuotës së Shoqërisë, si mëposhtë:

- **Z. Luan Lekli**, me numër personal identifikimi të dokumentit (NID): G40225114C, mbajtës i kartës së identitetit nr. 035766910, zotëruar dhe nënshkruar i një kuote të Shoqërisë, me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

8.2 Ndryshimi i mëposhtëm i Ortakut si dhe i numrit të ortakeve, nuk nënkupton ndryshim të Statutit por do të njoftohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Çdo Ortak duke u bërë zotëruar i kapitalit të Shoqërisë është dakord me përmbajtjen e këtij Statuti përveç se kur ndryshohet sipas Statutit dhe Ligjit.

#### **Neni 9 Zvogëlimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar**

9.1 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm në përputhje me këtë Statut, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit për Shoqëritë.

9.2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave (nëse ka) dhe fitimit.

9.3. Rritja e kapitalit mund të bëhet me lëshimin e kuotave të reja apo me rritjen e vlerës së kuotave ekzistuese.

9.4. Shoqëria nuk mund të blejë asnjë kuotë të saj. Megjithatë me qëllim zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet vendimit për zvogëlimin e kapitalit, Ortaku mund të autorizojnë Administratorin/rët të bëjnë blerjen e kuotave përkatëse apo pjesë të tyre dhe ti anulojnë ato.

### **Neni 10** **Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut**

10.1. Ortakë janë vetëm ata të cilët zotërojnë Kuota në Shoqëri.

10.2. Ortaku do të ketë të drejta votë në përpjesëtim me përqindjen e kontributit të zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë dhe që përfaqësohet nga Kuota e tij ose pjesë e Kuotës së tij. Ortaku ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, sikundër të drejtat e parashikuara nga ky Statut, dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Shoqëritë.

10.3. Ortakut do t'i jepen, pas kërkesës me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojnë dokumentet dhe raportet e Shoqërisë.

10.4. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotës/tave, transferohen tek çdo zotërues i ri për këto Kuota.

10.5. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaku mban përgjegjësi brenda limitit të vlerës së Kuotës që zotëron. Ortaku nuk mban përgjegjësi mbi vlerën e investimit të tij në kapitalin e Shoqërisë (përveç garancive dhe huave që ata lëshojnë).

10.6. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortakut të tij.

## **KREU - IV** **ORTAKU I VETËM**

### **Neni 11** **Kompetencat e Ortakut të Vetëm**

11.1. Ortaku i Vetëm është organi më i lartë vendim-marrës i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj strategjike, ekonomike dhe tregtare.

11.2 Ortaku i Vetëm ka kompetencat e mëposhtme:

- a. përcaktimin dhe miratimin e politikave të përgjithshme tregtare dhe të investimit duke i dhënë orientime Administratorit/rëve për realizimin e tyre si dhe duke mbikëqyrur dhe kontrolluar përmbushjen me sukses nga ana e tyre;
- b. emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/rëve dhe miratimin dhe nënshkrimin e kushteve kontraktore të bashkëpunimit me të/to, ose cakton nënshkruesin e kontratës me Administratorin/rët në emër të Shoqërisë;

- c. emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe të likuiduesve si dhe miratimin e skemës së shpërblimeve të tyre;
- d. monitorimi dhe mbikëqyrjen përmbushjen e detyrave dhe kompetencave të dhëna në këtë Statut nga ana e Administratorit/rëve, monitorim dhe mbikëqyrje të performancës së tyre, arritjen e objektivave kyç të përcaktuara tregtare dhe financiare dhe të zhvillimit të Shoqërisë të cilat i janë caktuar Administratorit/rëve;
- e. mbikëqyr përgatitjen e buxhetit, pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë si dhe i miraton ato. Mbikëqyr respektimin e objektivave buxhetore;
- f. ngrënë grupe të posaçme auditimit të përkohshme apo të përhershme, (auditimi financiar dhe të performancës së Shoqërisë) dhe cakton detyra auditimi të performancës dhe të aktivitetit të Shoqërisë në lidhje me çdo aspekt të aktivitetit dhe organizimit të Shoqërisë si dhe jep rekomandime dhe udhëzime të detyrueshme drejtuar Administratorit/rëve për masa, objektiva, sanksione që duhet të ndërmerren.
- g. ngarkon me detyra Administratorin/rët apo kufizon tagrat e tij të përfaqësimit dhe kompetencave;
- g. ndryshimi i Statutit;
- gj. përcaktimi dhe miratimi i rregulloreve të brendshme të Shoqërisë;
- h. miratimi i strukturës së brendshme organizative të Shoqërisë;
- i. miratimin ndarjes apo anulimit të kuotës si dhe miratimi i ndryshimit të numrit të kuotave në Shoqëri (ritje apo zvogëlimi i numrit të kuotave);
- j. miratimi i rritjes ose i zvogëlimit të kapitalit;
- k. miratimi i transformimit, ri-organizimit dhe likuidimit të Shoqërisë;
- l. miratimi në lidhje me shpërndarjen/destinimin e fitimeve vjetore si dhe i mbulimit të humbjeve;
- m. kryerjen e investimeve të reja në sektorë apo aktivitete të tjera jashtë Shoqërisë;
- n. shitjen, barrësimin apo disponimin në çdo mënyrë të pasurive të paluajtshme të Shoqërisë apo blerjen nga ana e Shoqërisë të pasurive të paluajtshme;
- o. blerjen, shitjen apo disponimin në çdo mënyrë të pasurive të luajtshme të Shoqërisë që prekin apo ndikojnë në aktivitetin kryesor të Shoqërisë si psh. linjat teknologjike, makineritë, mjetet e transportit etj;
- p. miratimi mbi pjesëmarrjen e Shoqërisë në kapitalin e shoqërive të tjera, dhënien apo marrjen e huave, obligacioneve, letrave me vlerë apo titujve të çdo lloji;
- q. marrjen dhe dhënien e huave të çfarëdolloj vlere apo forme;
- r. çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo Statuti;

**Neni 12**  
**Mbledhja**

12.1. Ortaku i Vetëm duhet të mbledhet të paktën 1 herë në vit.

12.2. Ortaku i Vetëm thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.

12.3 Ortaku i Vetëm mund të mbledhet sa herë e konsideron të nevojshme për interesin e Shoqërisë apo sa herë e thërret mbledhjen Administratori/rët.

### **Neni 13** **Mënyra e Thirrjes**

13.1. Ortaku i Vetëm thirret të vendosë për çështjet e shtruara përpara tij nëpërmjet thirrjes së mbledhjeve ose nëpërmjet konsultave me shkrim.

13.2. Ortaku i Vetëm mbledhet në selinë e Shoqërisë, ose në ambientet e degës së Shoqërisë apo në çdo ambient, qytet, provincë apo shtet tjetër, siç bihet dakord nga Ortaku.

## **KREU V** **ADMINISTRATORI/RËT**

### **Neni 14** **Administratori dhe kompetencat**

14.1. Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë Administrator/re, sipas vendimit të Ortakut të Vetëm.

14.2. Në momentin dhe për qëllimin e miratimit të këtij Statuti, Administratorët e Shoqërisë janë:

- **Z. Kristian Lekli**, datëlindja 24/10/1991, lindur në Berat, banues në Tiranë, me numër personal identifikimi (NID): J11024060N, me numër të pasaportes: BC1285764, i cili emërohet për një afat 3 (tre) vjeçar, me të drejtë riemërimi;
- **Z. David Lekli** datëlindja 02/04/1998 lindur në Berat, banues në Tiranë, me numër personal identifikimi (NID): J80402055W, me numër të pasaportës: BA9989154, i cili emërohet për një afat 3 (tre) vjeçar, me të drejtë riemërimi;

14.3 Çdo ndryshim i mëpasshëm në lidhje me shtimin apo zvogëlimin e numrit të Administratorëve apo zëvendësimin apo emërimin e një ose disa Administratorit/rëve, do të bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm dhe nuk do të konsiderohet si një ndryshim Statuti. Çdo emërim i një Administratori te ri ose zëvendësues, do të nënkuptojë fillimin e një afati të ri emërimi ose ri-emërimi.

14.4. Në rast të më shumë se një Administratori, kompetencat do të ushtrohen bashkërisht përveç se, dhe deri kur, Ortaku i Vetëm të ndajë kompetencat dhe të vendosë kufizime me anë të vendimit të tij. Ortaku i Vetëm në çdo moment mund të vendosë kufizime të tagrave të kompetencave edhe në rastin e një Administratori të vetëm, dhe të mund të kushtëzojë

kompetenca të caktuara të Administratorit/rëve me bashkë firmosjen e nga ana e Ortakut të Vetëm ose individë të tjerë brenda strukturës organizative të Ortakut të Vetëm apo Grupit;

14.5. Menjëherë pas emërimit të tyre, Administratori(rët) njohin se marrëdhënia e tyre me Shoqërinë ndërtohet mbi baza mirëbesimi; lidhur me këtë çdo vendim i marrë në çdo moment nga Ortaku i Vetëm për shkarkimin e tyre gjykohet si arsye e ligjshme, në përputhje me ligjet përkatëse dhe kontratën.

14.6. Ortaku i Vetëm ka të drejtë të shkarkojë Administratorin/rët në çdo moment dhe për çdo lloj arsye.

14.7. Nëse Administratori/rët e Shoqërisë nuk arrijnë të bien në një mendim të përbashkët lidhur me mbylljen, përfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve të tjera, çështja do të referohet tek Ortaku i Vetëm i cili vendos dhe/ose jep udhëzimet përkatëse të detyrueshme.

## **Neni 15**

### **Kompetencat dhe detyrimet e Administratorit**

15.1. Kompetencat dhe detyrat e Administratorit në kuadër të përfaqësimit të Shoqërisë përfshijnë:

- a. kërkesa/thirrja e mbledhjes së Ortakut të Vetëm, në rastet e specifikuar në nenin 12 dhe 13;
- b. menaxhimin e aktivitetit të përditshëm tregtar të Shoqërisë nëpërmjet implementimit të politikave, udhëzimeve, strategjive të përcaktuara nga Ortaku i Vetëm;
- c. përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
- d. kujdesin për mbajtjen në mënyrë të përshtatshme të dokumenteve, faturave dhe librave kontabël të Shoqërisë;
- e. kujdesin për mirëmbajtjen dhe mbarëvajtjen e aseteve të paluajtshme dhe të luajtshme të Shoqërisë përfshirë linjat dhe pajisjet teknologjike, makineritë, mjetet, situatën dhe gjendjen financiare etj;
- f. përgatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve që i paraqiten për miratim tek Ortaku i Vetëm;
- g. respektimin dhe përmbushjen (si dhe monitorimin e respektimit dhe përmbushjes nga Shoqëria) e objektivave, synimeve, llogaritjeve, kufizimeve të vendosura në buxhet apo planet financiare të miratuara nga Ortaku i Vetëm;
- gj. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, tatimeve dhe çdo autoriteti tjetër, kur është e nevojshme dhe/ose e kërkueshme nga ligji;
- h. raportimin përpara Ortakut të Vetëm, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;

- i. të sigurojë mbarëvajtjen e suksesshme të aktivitetit të Shoqërisë duke siguruar respektimin e rregullave dhe të legjislacionit si dhe duke siguruar që interesi i Shoqërisë të mos jetë i cënueshëm si pasojë e mos respektimit të kërkesave, ligjore financiare, tregtare, tatimore, rregullatore, kontraktore me palët e treta si dhe si pasojë e mos ndërmarrjes së hapave përkatëse të duhura dhe mbrojtës në aspektin financiar, ligjor dhe gjyqësor, për të mbrojtur interesat e Shoqërisë;
- j. të punojë për arritjen në mënyre sa më të suksesshme të mundshme të objektivave tregtare, financiare, ligjore të vendosura nga Ortaku i Vetëm;
- k. të zbatojë rekomandimet, udhëzimet, orientimet e Ortakut të Vetëm në lidhje me mbarëvajtjen e aktivitetit dhe organizimit të Shoqërisë;
- l. të zbatojë dhe rekomandimet, udhëzimet dhe orientimet e strukturave audituese të ngritura nga Ortaku i Vetëm, si dhe të strukturave të ngritura në kuadër të Grupit.
- m. të ndjekë zbatimin nga ana e punonjësve dhe strukturave të Shoqërisë, të rregulloreve të brendshme të Shoqërisë si dhe të Grupit të Shoqërive ku bën pjesë Shoqëria;
- n. zbatimin e rekomandimeve dhe të masave të propozuara nga grupet e auditimit të ngritura nga Ortaku i Vetëm ose të propozuara nga organet përfaqësuese të Grupit;
- o. kryerjen e detyrave të tjera të caktuara në ligj dhe nga Ortaku.

15.3 Administratori(rët) mbikëqyrin dhe sigurojnë që zyrtarët, agjentët, të punësuarit, auditorët dhe këshilltarët e Shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e Shoqërisë.

## **KREU VI**

### **ADMINISTRIMI FINANCIAR I SHOQËRISË**

#### **Neni 16**

##### **Ekspteri Kontabël i Autorizuar**

16.1. Ortaku cakton ekspertët kontabël të autorizuar (auditues) për të dhënë shërbimet e tij kundrejt Shoqërisë deri në mbylljen e vitit financiar.

16.2. Ekspertët duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **Neni 17**

##### **Viti ekonomiko-financiar**

17.1. Viti ekonomiko-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31-t të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar nis në datën e themelimit të Shoqërisë.

#### **Neni 18**

##### **Mbajtja e Llogarive**



18.1. Shoqëria do të mbajë llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj.

### **Neni 19**

#### **Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit**

19.1. Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të pasqyrave financiare të aprovuar nga Ortaku i Vetëm. Çdo ndryshim në destinacionin e fitimit do të caktohet nga Ortaku i Vetëm në përputhje me Statutin dhe me ligjet e zbatueshme.

19.2. Në bazë të Ligjit për Shoqëritë, Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek Ortaku vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:

(i) asetet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj te fundit;

(ii) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm;

19.3. Administratoret lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 20.2 më sipër. Ndërsa kur gjendja e Shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush kërkesat sipas 20.2, Administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

19.4. Administratoret përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

## **KREU VII**

### **SHOQERIA SI PJESTARE E GRUPIT TË SHOQËRIVE**

### **Neni 20**

#### **Shoqëria si pjesë e Grupit**

20.1. Shoqëria në rast se zotërohet ose kontrollohet nga një Ortak i Vetëm i cili është person juridik, atëherë është pjesë e grupit të shoqërive të zotëruara nga Ortaku i Vetëm ose të zotëruara nga ortaku (person juridik) i Ortakut të Vetëm si dhe shoqërive të zotëruara nga këto shoqëri ose nga vetë Shoqëria ("Grupi").

20.2 Në këtë rast strukturat dhe organet e brendshme të Ortakut të Vetëm si entitet më vete apo të ortakut të Ortakut të Vetëm do të konsiderohen automatikisht si struktura apo organe përfaqësuese të Grupit kundrejt Shoqërisë. Vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm ose ortakut të Ortakut të Vetëm, struktura të brendshme të shoqërive të tjera të Grupit mund të quhen struktura apo organe përfaqësuese të Grupit, rast pas rasti.

### **Neni 21**

#### **Auditimi i Brendshëm dhe Kontrolli i Shoqërisë nga ana e Grupit**

21.1 Shoqëria do të jetë objekt auditimi të brendshëm dhe kontrolli të brendshëm financiar si dhe i performancës apo i përmbushjes së parashikimeve të këtij Statuti dhe të politikave

dhe udhëzimeve të Ortakut të Vetëm. Ky kontroll i brendshëm do të ushtrohet nga ana e Ortakut të Vetëm i cili vepron me anë të strukturave të brendshme audituese në brendësi të strukturës organizative të tij apo nga grupe të ngritura në mënyrë të përkohshme apo të përhershme nga Ortaku i Vetëm në përbërjen e të cilëve mund të ketë specialistë të punësuar nga çdo shoqëri që është pjesëtare e Grupit;

21.2 Departamentet e tjera të strukturës së brendshme të Shoqërisë do të raportojnë, vejnë në dispozicion dokumente dhe sqarime si dhe do të përmbushin rekomandimet dhe udhëzimet e ardhura nga Ortaku i Vetëm dhe strukturat përfaqësuese të Grupit sipas pikës 21.1 më lart;

21.3 Administratori do të marrë masat e nevojshme për përmbushjen e paragrafit 21.2 nga ana e departamenteve të Shoqërisë si dhe do të marrë masa për përmbushjen e rekomandimeve të auditimeve dhe kontrolleve të brendshme të cilat vijnë sipas paragrafit 21.1;

## **KREU VIII**

### **MODIFIKIMI I FORMËS LIGJORE DHE PRISHJA**

#### **Neni 22**

#### **Modifikimi i Formës Ligjore**

22.1. Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Ortakut të Vetëm në përputhje me dispozitat respektive në Legjislacionin Shqiptar.

22.2. Shoqëria do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit të nevojshme në Shqipëri për këtë qëllim.



**KREU IX**  
**TË NDRYSHME**

**Neni 24**  
**Të tjera**

24.1 Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë.

**ORTAKU I VETËM**

**LUAN LEKLI**

